- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**  
\_\_\_\_\_

**Vula** \_\_\_\_\_

## Shtojca 8

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaraten e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*

c. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;*

ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*

d. *Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

1. *Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

### **2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019).
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019, 2020) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të prokuruar e përkatësisht **1,216,698** lekë.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2020 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2020.
4. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**



1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit ku të përfshihen postera, banera dhe harta me vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **486,679 (katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë)** lekë pa TVSH, të realizuara gjatë tri viteve të fundit.

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me entet publike, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me entin publik, **të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.**
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatëse të shitjes (*ku të shprehen qarte datat, shumat dhe shërbimet e realizuara*).

2. Për përgatitjen dhe rishikimin e gjithë materialit i cili do t'i vihet në dispozicion nga Bashkia Shkodër, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë nga administratori i shoqërisë, se do të marrë përsipër, përpunimin e materialit të grumbulluar për broshurat, fletë palosjet, hartë, rishikim dhe redaktim i tij sipas rasteve dhe do ta bëjë atë të përshtatshëm për botim edhe duke e redaktuar në shqip/anglisht sipas materialit.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë që merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë transportin dhe furnizimin e artikujve të kërkuar me shpenzimet e tij në vendndodhjen e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, sipas së cilës operatori i shpallur fitues do të realizojë printimet pasi të jetë konsultuar dhe të ketë marrë miratimin për elementet teknike, për të gjithë artikujt, me Autoritetin Kontraktor.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, sipas së cilës merr përsipër të realizojë printimet dhe materiale promocionale sipas kërkesave dhe afateve të kalendarit të aktiviteteve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** ose i përditësuar, mbi "Sistemin e menaxhimit të cilësisë", (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave, shërbimeve apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes*).

7. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një deklaratë nga administratori i shoqërisë, se do të marrë përsipër, se i gjithë materiali i përgatitur dhe i redaktuar do të përkthehet nga përkthyes i licencuar i gjuhës angleze. Për ato aktivitetet që janë të përshkruara në specifikimet teknike.
  
8. Përshkrim të kompanisë dhe CV e saj.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **I. DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT**

##### **Specifikime teknike për: Materiale publicitare për aktivitetet rinore/sportive**

###### **1. Baner**

Banerat duhet të jenë material që i reziston temperaturave të ulëta dhe të larta, si dhe shiut dhe diellit. Bannerat duhet të jenë në konizë druri dhe me përçina me mundësi për kapje me fasheta. Të kenë cilësi të lartë të ngjyrave 2778/1284 dpi. Fituesi duhet të vendosë Banerat në vendin e paracaktuar nga organizatorët si dhe të marrë përsipër zhvendosjen e tij në përfundim të aktivitetit, në ditët përkatëse. Gjithashtu merr përsipër dizejnimin e të gjitha bannerave sipas kalendarit të aktivitetëve të Drejtorisë së Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në bashkëpunim me to.

###### **2. Poster**

Posterat me madhësi 29.7cm x 42.0cm me cilësi të lartë ngjyrash 1920/1152 dpi dhe të printuara në foreks.

###### **3. Certifikata me korniza**

Certifikata të printuara me cilësi ngjyrash në karton të bardhë 210g me përmasa A4, për dizajnin e tyre dhe shënimet në brendësi duhet të merren shënimet nga organizatorët. Certifikatat duhet të jenë të vendosura në korniza me përmasa 32 x 23cm. Kornizat duhet të jenë drurit ngjyrë të zezë dhe me xham të qartë, me mundësinë për t'u vendosur në mur vertikalisht dhe horizontalisht.

###### **4. Kupa**

Kupat duhet të jenë me përmasave të ndryshme. **3** copë me përmasa 30 x 10 x 19 cm dhe specifike për atletikë, me një person i cili vrapon të gdhendur në majë, **5** copë me përmasa 20 x 10 x 10 standarte dhe **5** copë me përmasa 45 x 20 x 29 cm specifike me top volejboli të gdhendur në metal në majë të tyre. Kupat duhet të jenë material metalik, ngjyrë ari, bazamenti material druri i zi. Kupat duhet të kenë në bazamentin e secilës pllakatë alumini me përmasa sa bazamenti dhe të kenë të gdhendura shkrimet sipas sugjerimit të organizatorëve.

###### **5. Medalje**

Medaljet duhet të jenë metalike ngjyre ari me diameter 6 cm. Me lidhëse të kuqe ku është i printuar emri i aktivitetit i cili jepet nga organizatorët në bazë të aktivitetit. Medaljet kanë në qendër të tyre të gdhendur shënimet sipas aktivitetit. Shënimet jepen nga organizatorët.

## **6. Spila**

Spila rrethore 44 mm diametër, me ngjyra me kapëse horizontale në pjesën e pasme. Dizajni i tyre punohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

## **7. Roll up banner**

Banner me mekanizëm me sustë i cili mbyllet vetë në formë tubi. Përmasat 200 x 120 cm. Mekanizmi ka shkop i cili montohet në pjesën e pasme dhe bën të mundur qëndrimin drejt të bannerit. Gjithashtu poshtë tij, mekanizmi ka edhe 2 këmbë të palosshme.

## **II. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK**

### **Specifikime teknike për:**

**1. Materiale Promocionale** – Materiale Promocionale – Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje P10430.O2.A1, Dita ndërkombëtare për familjen – 15 Maj P10430.O2.A2, Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore P10430.O2.A4.A1, Dita ndërkombëtare e gruas, 8 Marsi P10430.O3.A4, Zbatimi i Planit Lokal të veprimit për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge P10430.O1.A1 , Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen P10430.

**2. Materiale për edukimin dhe argëtimin e fëmijëve** – Plani i zhvillimit lokal për komunitetin Rom dhe Egjiptian.

Materialet promocionale do të përdoren gjatë gjithë vitit për aktivitete të ndryshme në bazë të kalendarit të aktiviteteve dhe ditëve ndërkombëtare, sipas datave të përcaktuara qartë nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik i shpallur fitues në bashkëpunim me autoritetin kontraktor i realizon materialet promocionale në respektim të datave dhe mesazheve për çdo fushatë sensibilizimi që do të zhvillohet. Afatet, mesazhet, ideimi do vendosen në bashkëpunim me autoritetin kontraktor.

### **Materialet e kërkuara si më poshtë:**

- 1. Badge transparent plastik** me dimensione 62 mm x 106 mm sipas fotos bashkangjitur.
  - Varëset e gjatë për vendosjen e badge-ave duhet të jenë material polyester të markuara në të dyja anët, me kapesen e metalit për vendosjen e badge-ave.
  - Printimi në material kartoni, printim me ngjyra, me foto dhe informacione shtesë



2. **Maska jo – mjekësore** të printuara tekstili material pambuku me tre shtresa, të mbulojnë gojën dhe hundën. Ngjyra vendoset me kontraktorin dhe e markuar me logo në të majtë dhe iletiku të jetë në të njëjtën ngjyrë me maskën, stampim full color, produkt shumëpërdorimësh, larje higjenike me 60° C .
3. **Video me xhirim** Video duhet të ketë karakteristikat si më poshtë:
  - Konceptimi i videos dhe skriptit
  - Xhirime dhe animacion
  - Gjatesi 60 sek
  - Me muzike
  - Efekte zanore speciale
  - Efekte te videos dhe imazhit
  - Voice over (teksti do të miratohet në bashkëpunim me operatorin kontraktor)
  - Titra (OSE SLOGAN nëse përcaktohet)
  - Cilesi HD 4K

Video do realizohet në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor dhe do transmetohet në rrjete sociale si pjesë e fushatës ndërgjegjësuere.

Video duhet të dorëzohet edhe në format CD.

4. **Postera A3** me përmasa 42 – 29.7 cm, me luster , rezistente nga kushtet atmosferike.. Të kenë logo dhe përmbajtje të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, për fushtata të ndryshme të ndërgjegjësimit dhe sloganit të fushatave.
5. **Ftesa** me dimensione 10 x 15 cm, 400 gsm/shtyp dig relief color 4/4 glos. Të kenë logo dhe përmbajtje të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.
6. **Shporta kashte**, të punuara me dorë me përmasa 13 cm x 20 x 30cm me bisht. ngjyrë natyrale kashte.
7. **Lule natyrale** karafil i pakeluar sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
8. **Korniza të thjeshta A4** për të vendosur certifikatat në ngjyrë të bardhë.
9. **Certifikata** në letër 350 gr mat, printim me ngjyra, format A4. Me përmbajtje të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.
10. **Dizenjimi dhe Printimi** i fletëpalosjeve me Letër 250 gr m2 mat, formati 210 x 297 shtyp 4/4 me 3 palosje. Me dizeno dhe përmbajtje te përcaktuar nga autoriteti kontraktor për fushata të ndryshme të ndërgjegjësimit dhe sloganit të fushatave.
11. **Baner adeziv** mbulues + stampim Imazhi, Pergatitje per print, montim dhe ngjitje e adezivit me permasa 2.20 \* 2.8 m; Total = 6.2 m2. Baneri të ketë logo dhe përmbajtje të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Banerat do kenë pamje të ndryshme në bazë të sloganit të 2 fushatave të ndërgjegjësimit.

12. **Roll up** me dimensione 1 x 2.2 m, me mekanizëm , printim me ngjyra, me rezolucion të lartë në banner 450 gr . Baneri të ketë logo dhe përmbajtje të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.
13. **Dizenjimi dhe printimi i fletë informative** (flyer), me format 25.5 x 12 cm, 350 gr/m2 MAT, printim dixhital gloss me relief, ngjyra 4/4. Me përmbajtje të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.
14. **Dizenjimi dhe printimi i çanta pëlhere**, me dimensione 44 x 38 cm, materiale pëlhurë 100 % poliestër Oxford 270 gsm, Rripi i çantës material polipropilene (nylon) 65 x 2.5 cm. Stampimi 100 % e sipërfaqes me ngjyra në 2 anë për temperaturë larje deri në 60°. Qepje e brendëshme me bordator poliestër 2.2 cm. Përmbajtja dakortësohet me Autoritetin Kontraktor. Çantat do të printohen me ngjyra dhe 2 imazhe të ndryshme sipas fushatave ndërgjegjësuese.
15. **Kartolina në format A6**, printim në karton 350 gr mat, ngjyra 4/4. Me modele dhe pamje te ndryshme pasi dakortësohet me operatorin kontraktor.
16. **Stilolapsa të personalizuar**. Të shkruajnë blu, me majë të hollë, material plastik cilësor trupi. Të kenë logo dhe përmbajtje Sipas konceptit kreativ të të gjithë fushatës ndërgjegjësuese.
17. **Flamastra Colormaxi** me majë të plotë 12 ngjyra. Komplet i shkëlqyeshëm i 12 bojrave të ujit me fibër të gjerë në ngjyra të ndryshme.Maje konike e madhe për vija të holla dhe të gjera (3 mm - 6 mm). Stilolapsa të përshtatshme për fëmijë, 3 vjet dhe më të vjetër.
18. **Fletore Punë Dore** me ngjyrat bazike, me 20 fq, A4.
19. **Fletore A5**, 52 fletë me vija dhe me katrore . Fletorja përmban 52 fletë letre format A5. Trashësia e fletës : 70gr/m2 mund të shkruhet me të gjitha llojet e stilolapsave dhe lapsave.
20. **Lapsa me ngjyra 12 ngjyra** , janë lapsa për t'u ngjyrosur pa dru me një zemër shumë të fortë. Lapsa me ngjyra kanë plumba me diametër 3.3 mm. Ato ofrojnë ngjyra të ndritshme, janë të lehta për tu mprehur dhe, duke qenë pa dru, nuk ndahen nëse prishen.
21. **Kuti organizimi plastike transparente**, multibox me ngjyrë transparente, materiali plastik, kapaciteti : 18 lt, gjerësia : 40 cm, thellësia 34 cm, lartësia 17 cm, me kapak
22. **Kuti organizimi plastike transparente** 30x30x15 multibox me ngjyrë transparente, materiali plastik, kapaciteti 10 lt.
23. **Orë muri**, diametri.30 cm, strukturë plastike, trashësia 4cm, materiali i strukturës plastik, ngjyrë e bardhë.
24. **Paisje Plastifikimi A4**, Laminator për formatin A4, Ngrohët për 90 sec në momentin që shtypet butoni ON, Pajisja të ketë të aktivizuar butonin e sigurisë; në momentin që ju e harroni pajisjen ndezur, të fiket automatikisht pas 1 ore, me 2 vjet garanci, cilësi e lartë.
25. **Leter plastifikimi** 0.08mm, A4. Ideal për të plastifikuar dhe për të ruajtur dokumentet nga ndotja, grisja. materiali plastik, formati A4,Trashësia 75 gr, Ngjyra: Transparente

26. **Marker me ngjyra të ndryshme**, shënjues i përhershëm me bojë me bazë alkooli. Me formë moderne dhe veshje të rehatshme, gjerësi të vijës 0.7-3.5mm. Marker ideal për shkrime mbi të gjitha llojet e sipërfaqeve.
27. **Kartona me ngjyra**, me përmasa 50 x 70 cm, në ngjyra të ndryshme.
28. **Korrektor stilolaps** 8ml.
29. **Libra me ngjyrosje** për fëmijë A4. Me karaktere të ndryshme.
30. **Tabela të bardha** "White Board" për në mur me dimensione 60 x 90 cm. e cilësisë së lartë me sipërfaqe zmalte. Fshihet lehtë me fshirëse të thatë. Ka një sipërfaqe me qëndrueshmëri të gjatë. Kjo tabelë është e përshtatshme për përdorim në shkolla, zyra dhe në shtëpi. Kornizë alumini me kënde plastike në ngjyrë të zezë. Mund të montohet lehtë në mur horizontalisht ose vertikalisht.
31. **Tabelë edukative për fëmijë**, me përmasa 25cm\*9cm\*29cm. Tabela ka dy krahë ku mund të shkruhet si me marker ashtu edhe me shkumës, e përshtatshme për t'u përdorur mbi tavoline, ideale për të mësuar numrat, veprimet aritmetike, trupat gjeometrike dhe më shumë.
32. **Tabele kashte** (tape) me dimensione 60 x 90 cm, me kornizë MDF.
33. **Stilolapsa të thjeshte blu dhe të kuq**, cilesor, plastik.
34. **Set Lodra Kuzhina Plastike 3 D**, Ushqim Fruta Perime Prekje Perimesh Lodra edukative Gatuaj Kuzhinë 18copë /pako. Material plastik i pademshem per femijet.
35. **Komplet kafshe deti + pylli** gome 3 D. Material plastik i pademshem per femijet.
36. **Komplet enë kuzhine 3 D**. Material plastik i pademshem per femijet
37. **Litar për femije**, gjatësia 1.5 m Litar me material najloni dhe plastike, Ngjyre blu, Paloset, Perdoret ne palester,shtepi apo natyre.
38. **Lapsa të thjeshtë plumbi**, me majë të hollë dhe material cilësor.
39. **Puzzle të thjeshta për fëmijë**. Me kuti kartoni me dimensione 330x254 mm, me 60 cp me përralla të ndryshme.
40. **Ngjitës i lëngshëm**, 250 gram, me shishe. Ai vepron mbi letër, foto, karta etj. Nuk përmban elementë të dëmshëm.
41. **Pistoletë për ngjitje me silikon** si dhe shufra silikonit te përshtatshme për hancraft.
42. **Evidenciator me ngjyra të ndryshme**, me majë në formë dalte e cila ndihmon për nënvijëzime ose evidentime nga 1-5mm, si dhe është i gomuar për më shumë komfort dhe kontroll, me ngjyrë të ndezur fosforishente, e cila thahet menjëherë dhe nuk është toksike.

### **III. DREJTORIA E TURIZMIT**

#### **Specifikime teknike për:**

##### **1. Prodhimi i materialeve promocionale te tilla si dosje, stilolapsa, çanta, çakmake etj "**

- Çantat e kartonit duhet të jenë me shkëlqim, me dizenjo në të dyja anët ku nga njëra anë të jetë logoja zyrtare e Bashkisë Shkodër dhe nga ana tjetër të jetë logoja e markës zyrtare e Turizmit të territorit të Bashkisë Shkodër. Formatit duhet të jetë minimum A4 që të mbajë më shumë se 2 kg.



- Mbjtëse çelësash me material druri e personalizuar me logon e markës zyrtare të Turizmit të territorit të Bashkisë Shkodër dhe mbajtësja rrethore të jetë me material metali.



- Blloku i shënimeve duhet të jetë me llastik, të jetë në formatin A5 me përmasa 15x21cm dhe të ketë 180 faqe, të jetë në fletë të bardhë jo me katrore dhe as me viza. Kopertina të jetë imitim lëkure, në ngjyrë të zezë dhe të ketë të vendosur logon e markës zyrtare të Turizmit të territorit të Bashkisë Shkodër. Logimi llakim parcial.



- Konceptim dhe design të flamujve promocional që të ketë në të dy krahet hartën e Bashkisë Shkodër dhe dy logot, logon zyrtare të Bashkisë dhe logon e markës zyrtare të Turizmit të territorit të Bashkisë Shkodër. Të jetë në formatin 3 m lartësi X 80 cm gjerësi dhe të ketë bazament plastik me mbushje me ujë.



- USB 16 GB e gravuar me logon e Bashkisë dhe me logon e markës zyrtare të Turizmit të territorit të Bashkisë Shkodër.





- Cakmakë plastik të loguar në ngjyrë të bardhë me logon e markës zyrtare të Turizmit të territorit të Bashkisë Shkodër nga njëra anë dhe logon zyrtare të Bashkisë nga ana tjetër. Përmasat 23×80×9 mm.



## 2. Përgatitja dhe publikimi i itinerareve turistike

- Materiali duhet të përmbajë të paktën 10 itinerare me biçikleta të territorit të Shkodrës. Në faqet e këtij materiali, pedaluesi duhet të gjejë hartën e përgjithshme të të gjithë itinerareve si dhe hartat e veçanta për secilin pedalim.
- Broshura duhet të ketë min 4 faqe përshkrim të territorit ne fillim
- I gjithë materiali në total duhet të jetë minimumi 35 faqe plus dy kopertinat.

Për çdo itinerar duhet të ketë përshkrime:

- Emri
  - Gjatësia ne kilometra
  - Koha mesatare.
  - Niveli i vështirësisë. (duke specifikuar nëse është për të gjithë, për persona që kanë përgatitje të mirë fizike apo për sportistë)
  - Disniveli (disa programe e kanë, nqs është disponibel
  - Lartësia maksimale mbi nivelin e detit.
  - Cilësia e rrugës. (nëse është e asfaltuar ose jo, ose pjesërisht e asfaltuar, nëse është me cakull, gurë ose dhe e rrahur, për sa të jetë e mundur)
  - Përshkrim (pikënisja, fshatrat që përshkohen, objekte ose panorame me interes, vecanti të tjera që mund të lidhen me ngjarje ose personazhe, etj. min 3 rreshta - max 6 rreshta)
  - Hartë
  - Foto
- Materiali i printuara (minimumi 10 itinerare turistike)
  - Përmasat H 120 mm, L 200 mm, lloji i letrës mat 160 gr printim në të dy anët ndërsa kopertina te jete me leter 350 gr dhe mbi të shkruhen titulli dhe dy logot, ajo e Bashkisë Shkodër dhe logoja e Turizmit.
  - Lloji i shtypit: offset 4/4 ngjyra; plastifikim lustër 4/4

- Të sigurohet një design profesional dhe të një standarti të lartë.
- I gjithë informacioni përshkrues do të përgatitet nga operatori fitues. Drejtoria e Turizmit pranë Bashkisë Shkodër do të miratojë versionin përfundimtar të designimit dhe përgatitjes për shtyp të materialit. Operatori ekonomik fitues, duhet të paraqesë pranë zyrës së turizmit të Bashkisë Shkodër, paraprakisht minimumi dy modele designimi për miratim të modelit final.
- Itineraret do të behen vetëm në gjuhën angleze.
- Operatori duhet të sigurojë të drejtën e autorit

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet:

**Afatet e lëvrimit:** nga data e lidhjes së kontratës deri me 31.12.2021.

*Shënim: I gjithë materiali i përgatitur dhe i redaktuar do të përkthehet nga përkthyes i licencuar i gjuhës angleze*

**Shtojca 11**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

## Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>3</sup>Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

### Shtojca 13

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_



*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra

\_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 15

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes

së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

#### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

#### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
